



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 12 qershor 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Ahmet Isufi, Avdullah Hoti, Albert Kinolli dhe Verica Çeraniq.

Mungoi: Faton Topalli, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Shqipe Pantina, Ali Lajçi dhe Zafir Berisha.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

Pjesëmarrësit tjerë: Hana Pula, Bedri Haxhijaj dhe Beqë Hadergjonaj nga N.P “Drini i Bardhë”; Vlora Spanca, Enver Buqolli dhe Ganimete Dalloshi nga ZKA; Artan Murati nga KDI; Margarita Rashiti nga BIRN.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura me datë 05.06.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të mbajtur më 05.06.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 05.06.2018, nuk u miratua në mungesë të kuorumit.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017

Kryetari, njoftoi se në cilësinë e raportuesit për shqyrtimin e raportit të Auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017 është Deputeti Albert Kinolli dhe ftoi për ta prezantuar raportin dhe të gjeturat nga raporti.

Albert Kinolli, prezantoi në pika të shkurta raportin e Auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të japim opinion për PVF-të e vitit 2017, për arsye e përmendura në vijim: kërkesat tjera afatshkurtra të prezantuara në PFV ishin 11,1350€. Megjithatë, kompania nuk posedon dëshmi lidhur me përbërjen e kësaj shume. Kompania në fund të vitit kishte bërë inventarizimin e aseteve dhe kishte përgatitur raportin për inventarizim i cili nuk përputhet me regjistrin e aseteve. Detyrimet ndaj punëtorëve (2008-2016) të prezantuara në PFV e vitit 2017 ishin 97,837€. Kompania ka ofruar dëshmi për obligime ndaj punëtorëve për periudhën 2013-2015 në vlerë prej 61,029€ dhe obligime për ish BD në vlerë prej 23,303€. Të hyrat e shtyera nga grantet të prezantuara në PFV ishin 2,608,651€. Mirëpo, kompania nuk posedon regjistrime kontabël lidhur me të hyrat e shtyera. Kapitali i emëruar i prezantuar në PFV ishte 1,147,934€. Përveç kapitalit themeltar që është cekur në statutin e kompanisë në vlerë 25,000€, kompania nuk posedon shënime kontabël apo dëshmi të tjera lidhur me përbërjen e kësaj shume. Kompania nuk ka mbajtur regjistrime në kontabilitet lidhur me fitimet/humbjet e mbajtura dhe nuk ishte në gjendje të ofronte evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për këtë zë. Llogaritë e arkëtushme në PVF-të e vitit 2016 ishin 62,216€, ndërsa kompania gjatë vitit 2017 kishte njohur 48,960€ si shpenzime për borxhe të këqija. Menaxhmenti i kompanisë nuk ishte në gjendje të na ofrojë evidenca lidhur me llogarit të cilat i ka njohur si borxhe të këqija. Kompania tek të hyrat nga shitja e aseteve ka regjistruar të hyra në vlerë prej 15,066€ të cilat janë realizuar nga shitja e dy traktorëve, një ekskavatori dhe një kompresori, mirëpo kjo vlerë nuk është dashur të njihet si e hyrë. Si pasojë e mungesës së evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme, ZKA nuk kishte mundur me konfirmuar saktësinë e pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet. Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për zërat e prezantuara në PFV.

Vlora Mehmeti, prezantoi në pika të shkurtra të gjeturat kyqe dhe arsyen pse ZKA nuk ka mundur të jap opinionin e vete për sa i përket PVF të Ndërmarrjes Drini i Bardhë.

Avdullah Hoti, pyeti se a është pajtuar menaxhmenti i Ndërmarrjes me të gjeturat e Auditorit të Jashtëm, dhe se i keni lexuar të gjeturat, përfshirë këtu edhe pranimin me shkrim për këto të gjetura?

Ahmet Isufi, theksoi se gjendja financiare dhe e menaxhimit e prezantuar në këtë raport të auditimit të jashtëm nuk është e kënaqshme, mua me intereson se cili është hapi i ri i menaxhmentit për ti plotësuar rekomandimet e dhëna nga auditori i jashtëm?

Beqë Hadergjonaj, u përgjigj në pyetje e deputetëve, po ashtu theksoi se pajtohet me të gjeturat e Auditorit të Jashtëm, theksoi se shumica e të gjeturave janë të trashëguara nga menaxhmenti i kaluar.

Kryetari, pyeti sa i përket pagave të Kryesuesit të Bordit dhe anëtareve të Bordit, ndërsa për sa i përket punëtorëve kemi informata për lartësinë e pagave të tyre? Po ashtu pyeti se si është e mundur që një donacion në shumën mbi 2 milion euro të menaxhohet dhe kontrollohet vetëm nga Kryeshefi Ekzekutiv ndërsa për këtë të mos ketë njohuri Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes, si dhe mos prezantimi në Pasqyrat Financiare të kësaj shume tregon për një reprezentim jo real dhe situatës jo të mirë të organizimit dhe raportimit të Ndërmarrjes.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë S.H.A. Pejë për vitin 2017, të mos adresohet në Seancë Plenare, rekomandimet do të diskutohen në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Me këtë u mbyll edhe takimi, Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017, i paraparë të shqyrtohet në këtë takim do të shqyrtohet në njëren nga mbledhjet e radhës së Komisionit;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj